



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT
DHE SPORTIT

BURSA PËR STUDIME MASTER NË HUNGARI, (FAO), VITI AKADEMIK 2017-2018

Në bazë të marrëveshjes së nënshkruar ndërmjet qeverisë hungareze dhe Organizatës së Ushqimit dhe Bujqësisë (FAO), qeveria hungareze ofron bursa për studime **Master** në Universitetin Szent Istvan, pranë Fakultetit të Ekonomisë dhe Shkencave Shoqërore, Fakultetit të Shkencave Hortikulturale dhe Fakultetit të Shkencave Bujqësore dhe Mjedisore në drejtimet e mëposhtme:

- Zhvillim Rural dhe Agrobiznes;
- Hortikulturë;
- Administrim Bujqësor të Ujrave.

Për të gjitha degët e studimit, studimet do të zhvillohen në **gjuhën angleze**.

Bursat që do të akordohen do të mbulojnë:

- Aplikimin dhe tarifat e studimit gjatë të gjithë periudhës së studimit, duke përfshirë këtu librat bazë dhe shënimet;
- Fjetje dhe akomodim;
- Shpenzimet e jetesës, dhe
- Sigurimin Shëndetësor.

Përzgjedhja e studentëve do të bëhet në dy faza:

Faza I: Aplikimi fillestar do të bëhet tek FAO dhe dosjet e kandidatëve të përzgjedhur do t'i përcillen Ministrisë së Bujqësisë në Hungari, e cila do t'i dërgojë pranë Universitetit përkatës sipas përzgjedhjes së kandidatëve;

Faza II: Kandidatëve mund t'u kërkohet të bëjnë një test me shkrim ose me gojë të gjuhës angleze si pjesë e procesit të përzgjedhjes. Universitetet pas kësaj, do të informojnë secilin prej kandidatëve të përgjedhur.

Kandidatët, do të përzgjidhen në bazë të kriterëve si vijon: rezidenca/shtetësia e njërit prej vendeve të listuara, rezultatet e shkëlqyera akademike, njohuritë e gjuhës angleze, motivimi, shëndeti i mirë dhe mosha (preferohen studentë nën 30 vjeç).

Aplikantët e interesuar duhet të përgatisin një dosje, të cilën do ta dërgojnë me EMAIL në adresën e FAO REU-Scholarship@fao.org në periudhën nga **04 janar 2017** deri në **28 shkurt 2017**.

Për një informacion më të detajuar për mënyrën e aplikimit dhe të përgatitjes së dokumentacionit referojuni materialeve informativë që gjenden në adresën: <http://www.opportunitiesforafricans.com/fao-hungarian-government-scholarship-2017-2018-for-study-in-hungary-fully-funded/>.

DREJTORIA E INTEGRIMIT EVROPIAN DHE PROJEKTEVE